

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve: N. (T.) F., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së dhe E. (T.) F., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par. 5 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPK në Prishtinë tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.773-10/2010 dt.12.10.2011, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik me datë 22.09.2016, të mbajtur në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina-Ibrahim Fejza, të dëmtuarin B. H., të akuzuarin E. F. dhe mbrojtësit të tij av. T. G., e në mungesë të dëmtuarit B. H., me datë 23.09.2016 në mungesë të gjitha palëve mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 07.10.2016, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit,

N. F., i biri i T. dhe F. e gjinisë A., i lindur më *data e lindjes....*, në fshatin D., Komuna e P., ku edhe jeton, me numër personal të identifikimit-*numër personal...*, i pa martuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, me profesion Ekonomist, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i gjykuar më parë, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë, ka qëndruar në paraburgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, gjegjësisht prej datës 25.01.2010 deri më datën 25.02.2010.

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

REFUZHET AKUZA

Sepse:

I.Me datën 21.01.2010, rreth orës 15:00, në rrugën “...” afër kafiterisë V. përballë shkollës së mesme ekonomike “I. B.” në P., i pandehuri pas një zënke me të dëmtuarit B. dhe B. H., ashtu që me dashje i sulmon fizikisht të dëmtuarit duke i goditur me shkopinj të drurit, mjet ky i përshtatshëm për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor ose për ta dëmtuar rëndë shëndetin nëpër pjesën e trupit, me ç`rast të dëmtuarve B. dhe B. u shkakton lëndime të lehta trupore.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 e lidhur me par. 1 të KPK-së.

Për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale, në kuptim të nenit 91 par.5 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Ndërsa i akuzuari,

E. F., i biri i T. dhe F. e gjinisë A., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin D., Komuna e P., ku edhe jeton, me numër personal të identifikimit-*numër personal...*, i pa martuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik dhe Masterin e Ekonomisë, me profesion Ekonomist, i punësuar në QKUK-Prishtinë, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i gjykuar më parë, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë, ka qëndruar në paraburgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, gjegjësisht prej datës 25.01.2010 deri më datën 25.02.2010.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

II.Me datë 21.01.2010, rreth orës 15:00, në rrugën “...” afër kafiterisë V.përballë shkollës së mesme ekonomike “I. B.” në P., i pandehuri E. F. pas një zënke me të dëmtuarit B. dhe B. H., në atë mënyrë që me dashje i sulmon fizikisht të dëmtuarit duke i goditur me shkopinj të drurit mjet ky i përshtatshëm për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor ose për ta dëmtuar rëndë shëndetin, pastaj ka nxjerrë thikën dhe e ka goditur të dëmtuarin B. H. në pjesën e gjoksit dhe të barkut, shtatë herë me thikë, ashtu që i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore.

Me këtë ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par. 5 të KPK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 64, 73 dhe në bazë të nenit 154 par.1 nën par 5 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365,370, 450,453,463 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Të akuzuarin **E. (T.) F.**, me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, të cilin do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit **73 të KPK-së**, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej **1 (një) muaji**, gjegjësisht prej datës **25.01.2010 deri më datën 25.02.2010**.

I dëmtuari B. (I.) H., nga P. rr. “...” nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **250€ (dyqindpesëdhjetë/euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarve u konfiskohen dy shkopinjtë e drurit të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale.

A r s y e t i m

PPK-në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.773-10/2010 dt.12.10.2011, kundër të akuzuarve: E. (T.) F. nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par. 5 të KPK-së dhe N. (T.) F. nga fshati D., Komuna e P., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 e lidhur me par. 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar 16.11.2015, shqyrtimin e dytë me datë 21.12.2015 dhe shqyrtimet gjyqësore me datë 17.03.2016 dhe 22.09.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit, të dëmtuarit B. H., të akuzuarit E. F. dhe mbrojtësit av. T. G. nga P..

Gjykata lidhur me të pandehurin N. F., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 e lidhur me par. 1 të KPK-së, në shqyrtimin fillestar të datës 16.11.2015, pas precizimit të veprës penale nga prokurori i shtetit me aktvendim ka konstatuar se nga veprimi i fundit i gjykatës të datës 20.10.2011, ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale me datë 20.10.2014, në kuptim të nenit 90 par.1 nën par. 5 të KPK-së, që është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tri vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim, andaj në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së, merret aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar kundër të akuzuarit E. F. i cili deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u deklarua se mbrohet në heshtje.

Prokurori i shtetit I. F. në fjalën përfundimtare veç tjerash deklaroi: Mbetëm në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit E. F. dhe kërkoj nga gjykata që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari-dëshmitari B. H. në fjalën përfundimtare deklaroi: I bashkëngjitëm fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit, ndërsa nuk parashtroni kërkesë pasurore-juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. F. av. T. G. në fjalën përfundimtare veç tjerash deklaroi, për shkak të shkeljeve të mëdha të dispozitave të procedurës penale edhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor kërkoi nga gjykata të merr aktvendim për rihapjen e shqyrtimit gjyqësor për ta ftuar të dëmtuarin B. H. në shqyrtimin e ardhshëm gjyqësor, meqenëse i njëjti është e qartë që gjendet në Angli, kërkoi që ai të merret në pyetje përmes Institutit të Ndihmës juridike Ndërkombëtare në formë të shkruar apo ta marrim në pyetje atë përmes videolinkut dhe me këtë do të mund ti ikim shkeljes së qëllimshme të dispozitave të KPP-së dhe të respektohet parimi juridik dhe i paraparë me dispozita të KPP-së, që askush nuk mund të shpallet fajtor nëse nuk i ipet rasti që së paku një herë ta sfidoj deklaratën e dëshmitarit apo dëshmitarëve që janë dëshmitarë të prokurorisë, klientit tim kjo e drejtë iu mohua dhe me vendimin e më hershëm të kësaj gjykate e posaçërisht

vendimin e datës 17.03.2016 ku në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit që ka qenë kërkesë e ligjshme është shtyrë shqyrtimi gjyqësor në kohë të pacaktuar deri sa të sigurohet B. H. kurse shumë më pak është e rëndësishme prezenca e dëshmitares B. G.. Mbrojtësi më tej ka shtuar provat në bazë të cilave prokurori propozon që gjykata ta shpall fajtor z. E. F. është më se e qartë se të gjitha provat që janë administruara në këtë shqyrtim gjyqësor përveç deklaratës së z. B. H. janë të pa pranueshme, janë në kundërshtim të hapët dhe të qartë me dispozitat përkatëse të KPP-së, janë në kundërshtim me Kartën e OKB për mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve, janë në kundërshtim të thellë me dispozitat e Konventës Evropiane për të drejtat e të akuzuarve. Pa prezencën e z. B. H. prokuroria nuk ka lëndë-çështje penale.

I akuzuari E. F. në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se e shfrytëzon të drejtën e mbrojtjes në heshtje, ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi këtë gjendje faktike: Se i akuzuari E. F. me datë kohë dhe vendë si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi, pas një zënke me të dëmtuarit B. dhe B. H., me dashje i sulmon fizikisht të dëmtuarit duke i goditur me shkopinj të drurit e më pastaj ka nxjerrë thikën dhe e ka goditur të dëmtuarin B. H. në pjesën e gjoksit dhe të barkut, shtatë herë me thikë, ashtu që i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit B. H., deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit B. H. dhënë në Polici me datën 25.01.2010, deklarata e dëshmitares B. G. dhënë në Polici me datë 26.01.2010, deklarata e të akuzuarit E. F. të dhënë në polici me dt. 25.01.2010, ekspertiza mjeko-ligjore punuar nga Dr. T. G. të dt. 12.02.2010, raportit i këqyrjes në vendin e ngjarjes dhe skicës e datës 21.01.2010, si dhe fotodokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 par.1 dhe 2, si dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit B. H. dhënë në shqyrtimin gjyqësor, vërtetohet gjendja faktike, i cili veç tjerash deklaroi: Me datë 21.01.2010 rreth orës 3 (tre) ka mbërrë autobusi në Stacion të Autobusëve në P., vëllau B. më thirri dhe më tha se dua të pushoj eja ndërromë, u nisa nga shtëpia për me shku në kafe V. me marr çantën që më kishte thënë vëllau, me të mbërrë te dera e kafiteris më kanë goditur me shkop në kokë, shpinë dhe pjesë tjera të trupit E. dhe N., kam rënë në tokë në gjunjë, vëllau N. ka dal nga kafiteria që ishte brenda dhe që të dytë e kanë goditur me thika.

Nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit B. H. dhënë në polici me datë 25.01.2010, vërtetohet gjendja faktike i cili veç tjerash ka deklaruar: Me datë 21.10.2010 rreth orës 14:55 në rrugën “...” afër shkollës së mesme kam zbritur nga autobusi im, për të pirë kafe në kafiterin “V.” duke hyrë në kafe kam telefonuar me vëllaun tim B. dhe i kam thënë që të më zëvendësoj në punë si kundukter, posa kam hyrë në kafiteri pas një minute, ka ardhur vëllau B. dhe duke e hapur derën e lokalit (kafiteris), nga prapa kanë ardhur N. dhe E. me stupca dhe e kanë goditur që të dy dhe e kanë rrëzuar për toke dhe i kanë nxjerrë thikat kanë tentuar ta sulmojnë, menjëherë kamë dal

jashtë lokali dhe E. dhe N. janë larguar nga vëllau, me ta kanë qenë edhe tre persona tjerë dhe më pas N. ka ardhur në drejtim timin me thikë dhe më ka goditur në anën e majtë të gjoksit dhe në ato momente ja kam kapur dorën e djathtë me të cilën më ka goditur me thikë, nga prapa në shpinë më goditi me thikë E. tri herë dhe e kam dëgjuar E. duke thënë le se u krye dhe këtë e ke nga Baba F., pastaj N. dhe E. u larguan, në spital kam kuptuar se i kam shtatë plagë.

Nga deklarata e dëshmitares B. G. dhënë në polici me datë 26.01.2010, vërtetohet gjendja faktike e cila ka deklaruar: Me datën 21.01.2010, isha në pushim mes orëve kam shkuar në kafiterin "V." përballë shkollës "I. B." për të pirë një lëng, pas 2-3 minutave kam shkuar në klasë, pas pak kam dal prapë nga shkolla dhe kam parë një turmë me shumë persona të cilët u përleshën mes veti dhe kur u afrova e pashë se B.H. ishte i përgjakur të cilin e njoha se kam udhëtuar me autobusin e tyre dhe së bashku me policin e kemi dërguar në emergjencë, unë nuk e di përse janë ngatërruar.

Nga deklarata e të akuzuarit E. F. e dhënë në Stacionin Policor në P. me datë 25.01.2010, vërtetohet se i akuzuari e kishte pranuar se me datën 21.01.2010 rreth orës 14:45 te kafiteria "V." përball shkollës "I. B." pas një përleshje me stupca me B. dhe B. H. e ka nxjerr briskun nga xhepi i cili ka pasur tehun 5-6 cm dhe e ka goditur njërin prej vëllezërve disa herë, e të cilin brisk e ka humbur diku në rrugë.

Nga mendimi i ekspertit mjeko-ligjor T. (R.) G., vërtetohet se i dëmtuari B. H., ka pësuar plagë prerëse - shpuese të lokalizuara: dy në anën e majtë të kafazit të kraharorit, një në bark në anën e majtë, një në zonën ijore të majtë dhe një në torakolumbale të djathtë, një në zonën e gilzës së majtë, një në zonën e krahut të djathtë, të cilat plagë janë si pasojë e veprimit të mjetit të fortë dhe të furishëm mekanik të mprehtë i cili ka poseduar tehun dhe majën, kurse plaga mbretëse – shqyese në krahun e djathtë dhe luksacioni i nyjës së krahut të majtë, janë pasojë e veprimit përrreshqitor të mjetit të fortë dhe të furishëm mekanik – mbretës të topitur, nga të cilat janë shkaktuar Dëmtime të zakonshme të Rënda trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit të dëmtuarit B. H..

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, skicimi dhe fotodokumentacioni të datës 21.01.2010, vërtetohet data, koha dhe vendi i ngjarjes, gjurmët të cilat janë gjetur, njollat e gjakut, shkopinjtë të cilët janë përdorur gjatë kryerjes së veprës penale.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plotë deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit B. H., deklaratës së të dëmtuarit – dëshmitarit B. H. dhënë në Polici me datën 25.01.2010, deklaratës së dëshmitares B. G. dhënë në Polici me datë 26.01.2010, deklaratës të të akuzuarit E. F. të dhënë në polici me dt. 25.01.2010, ekspertizës mjeko –ligjore punuar nga Dr.T. G. të dt. 12.02.2010, raportit i këqyrjes në vendin e ngjarjes dhe skicës e datës 21.01.2010, si dhe fotodokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës, të cilat prova ndërliidhen njëra me tjetrën dhe vërtetohet se i akuzuari E. F. ka kryer veprën penale si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mënyrë të hollësishme analizoi mbrojtjen e të akuzuarit E. F. të ushtruar nga mbrojtësi i tij av. T. G. duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e tij për ta sfiduar deklaratën e të dëmtuarit-dëshmitarit B. H. në shqyrtim gjyqësor, gjykata e ka vlerësuar vetëm si pretekst të mbrojtës për ta zvarritur edhe më tej procedurën penale, për faktin se disa herë janë shtyrë shqyrtimet

fillestare dhe shqyrtimi gjyqësor në mungesë të mbrojtësit, i dëmtuari B. H. i cili gjendet në A. ka prezantuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.07.2016, në të cilin shqyrtim gjyqësor kanë munguar mbrojtësi av. T.G. dhe i akuzuari, ku mbrojtësi përmes një parashtrise të datës 26.07.2016, e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në shqyrtim gjyqësor për shkak se është i zënë në një gjykim tjetër dhe po ashtu ka sqaruar se nuk do të prezantoj as i akuzuari me arsyetimin se nuk ka pranuar ftesë për shqyrtim gjyqësor, për deri sa gjykata në shkresat e lëndës ka pasur provën – fletëkthesën e PTK-së, se njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, gjykata e ka vlerësuar se i akuzuari me sugjerim të mbrojtësit nuk ka prezantuar në shqyrtim gjyqësor. Gjykata e ka treguar prapë seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 01.10.2016 në të cilën ka prezantuar i dëmtuari B. H., ndërsa prapë nuk ka prezantuar i akuzuari dhe as mbrojtësi i tij, pa ndonjë arsyetim nga mbrojtësi, nga kjo rezulton se mbrojtja ka pasur vetëm për qëllim zvarritjen e procedurës penale. Andaj gjykata e ka lexuar deklaratën e të dëmtuarit B. H. dhënë në polici me datë 21.01.2010, me propozim të prokurorit të shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.09.2016 duke u bazuar në nenin 338 par. 1 pika 1.1 të KPPRK-së, për shkak se nga shkresa e datës 20.09.2016 e pranuar në gjykatë me datë 21.09.2016, për mes të cilës i dëmtuari i lartcekur e ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantoj në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.09.2016 dhe nuk ka siguruar se kur mund të prezantoj në shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin për shkaqe shëndetësore, ashtu që prezenca e tij është e pa mundur tani përkatësisht e vështirësuar, me çka do ta pengonte edhe më tej zhvillimin dhe përfundimin e suksesshëm dhe në kohë të arsyeshme shqyrtimin e kësaj çështje penale, gjithashtu gjykata me propozimin e prokurorit të shtetit e ka lexuar deklaratën e dëshmitares dhënë në polici të datës 21.01.2010, gjë që edhe vetë mbrojtësi në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 17.03.2016 ka kërkuar që të lexohet deklarata e saj dhënë në polici, ndërsa sa i përket leximit të deklaratës së të akuzuarit E. F. në shqyrtim gjyqësor e cila është dhënë në polici me datë 25.01.2010, e për të cilën mbrojtësi av. T. G. ka kërkuar shpalljen e provës së pa pranueshme të kësaj deklarate me arsyetim se është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi që nuk ka pasur mbrojtjes, gjykata e ka vlerësuar si të pa bazuar, nga se nga procesverbali i intervistimit në stacionin policor në Podujevë, të datës 25.01.2010, rezulton se i akuzuari E. F., pasi që i janë lexuar të drejtat, e njëra ndër to se e ka të drejtën e avokatit dhe konsultimit me të para dhe gjatë marrjes në pyetje, i njëjti e ka refuzuar me vullnetin e tij duke e nënshkruar para leximit të drejtave dhe në të gjitha faqet e procesverbalit deri në fund të intervistimit. Andaj mbrojtja e të akuzuarit E.F. është e orientuar vetëm nga ikja e përgjegjësisë penale dhe zvarritja e procedurës penale.

Gjykata nuk e ka shpallur fajtor të akuzuarin E. F. duke u mbështetur vetëm në dëshminë e të dëmtuarit B.H. dhënë në polici e cila u lexua në shqyrtimin gjyqësor ose duke i dhënë rëndësi vendimtare kësaj dëshmie e cila nuk ka mundur të kundërshtohet përmes marrjes në pyetje nga mbrojtësi në shqyrtimin gjyqësor, po ashtu kjo gjykatë nuk e ka shpallur fajtor të akuzuarin duke u mbështetur vetëm në deklaratën e të akuzuarit ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratës së tij dhënë në polici e cila u lexua në shqyrtimin gjyqësor, nga se këto prova janë vetëm ndërlihdje me provat tjera e që vërtetohet gjendja faktike si në dispozitiv nën II të këtij aktgjykimi, gjykata në përpikëri ka respektuar parimin kontradiktor ku të gjitha palëve në procedurë u është dhënë mundësia e kundërshtimit të çdo prove të paraqitur në shqyrtimin gjyqësor konform nenit 361 par. 1 dhe 2 dhe 261 par. 1 të KPPRK-së, prandaj gjykata konstaton se në këtë çështje penale ka prova tjera të shumta përpos këtyre dyjave që u cekën pak më lart, të cilat ndërlihdhen njëra me tjetrën dhe pa asnjë mëdyshje vërtetojnë veprimet e ndërmarra të të akuzuarit me qëllim të kryerjes së veprës penale.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit E. F. përmbushen të gjitha elementet

qenësore të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par. 5 të KPK-së, për të cilën veprë penale gjykata e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën penale me dashje, me paramendim, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe ka dashur kryerjen e veprës penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, mosha e të akuzuarit E. F. në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë relativisht e re, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit për shkak se goditjet me thikë në pjesët vitale të dëmtuarit B.H. kanë mundur të jenë me pasoja vdekjeprurëse, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është jeta dhe shëndeti i të dëmtuarit, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale është shqetësuese, pasi që është kryer në qendër të qytetit pikërisht para shkollës se mesme ku është prezenca e madhe nxënësve të cilët janë të mitur, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbajnë pasi aktgjykim të merr formën e prerë. Me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale si dhe përgjegjësisë penale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të parapara sipas dispozitës së nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë në kuptim të nenit 73 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit B. H. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për pikën nën I të këtij aktgjykimi është marrë në kuptim nenit 454 par 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për pikën nën II të këtij aktgjykimi do të merret sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa vendimi për shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor është marrë për bazë kohëzgjatja e zhvillimit të procedurës penale, ku në këtë çështje penale janë mbajtur dhe shtyrë disa seanca gjyqësore, si dhe gjendjen ekonomike të akuzuarit, konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e mjeteve të përdorura për kryerjen e veprës penale është marrë konform nenit 60 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 363 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL
PKa.nr.148/2011, dt.07.10.2016**

**Sekretarja Juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.